



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 16, Datë 10.01.2018

MBI

MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË TË DHËNAVE DHE PROCEDURËN PËR AKSESIN E FURNIZUESVE NDAJ TË DHËNAVE TË OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 69 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draft– Rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike.

Konstatoi se,

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 69 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ERE përcakton formatin e të dhënave të OSHEE dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave.
- Në bazë të nenit 69 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi.
- Mbështetur në Rregullat për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE, pas marrjes së vendimit nr.159, Datë 04.10.2017, “Për fillimin e procedurës për miratimin e Draft-Rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ERE publikoi në shtypin e shkruar njoftimin në lidhje me sa më sipër, duke ftuar të gjithë palët e interesit të shprehin komentet e tyre.
- ERE, me shkresën nr. 666 Prot, datë 10.10.2017, dërgoi draftin e këtyre rregullave për marrjen e mendimit palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, Shoqatës AAES, Shoqatës FIAA, Shoqatës ACERC, OSHEE sh.a., OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e komenteve të palëve të interesit mbi sa parashikuar në draftin e kësaj rregulloreje, rezultoi që kanë mbërritur komente nga Shoqata AAES si dhe OSHEE sh.a.
- ERE me shkresën nr. 666/2 datë 02.11.2017 iu përgjigj shoqatës AAES, duke sqaruar se komentet e përcjella sa më sipër, nuk gjejnë zbatim në këtë rregullore dhe propozimet e AAES, kufizojnë të drejtat e furnizuesve në raport me aksesin në të dhënat e OSHEE.
- Pas përfundimit të afatit për marrjen e komenteve, u depozituan në ERE me shkresën nr, 666/3 prot, datë 10.11.2017, komentet e shoqërisë OSHEE sh.a.
- Pas marrjes së komenteve të OSHEE sh.a. ERE në datë 04.12.2017, organizoi një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesit, ku u diskutua dhe dakortësua se cilat nga propozimet e palëve mund të pranoheshin.
- Palët u sqaruan mbi legjitimitetin e propozimeve të tyre dhe ranë dakort mbi draftin e ndryshuar të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë *“Rregullat për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”* (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI